



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 17 shkronja k të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 40, nenit 19 shkronja k të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-1/298-10 dhe nenit 1 pika 3 të Rregullores për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 të datës 27 shtator 2012, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2015, miratoi:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-në HANDIKOS - QENDRA E REHABILITIMIT TË BAZUAR NË BASHKËSI NË PODUJEVË

Neni 1

OJQ Handikos – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë, për zhvillimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative të veprimtarisë, sipas objektivave strategjike të OJQ - së, për vitin 2015, mbështetet me mjete financiare në shumë të gjithmbarshme prej 14.784,00 €

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve bartet në konton bankare të OJQ - së përkatëse në këste mujore në shumë prej 1.232,00 €.

Neni 3

Vendimin e zbaton Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-005-16468
Podujevë,
4 shkurt 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi